

Përfshirja e qytetarëve

Ky udhëzues i shkurtër shërben për t'i mbështetur aplikantët e interesuar për të menduar për mënyrat dhe rëndësinë e ngazhimit të qytetarëve gjatë gjithë punës së tyre.

Përqendrimi në angazhimin e qytetarëve dhe në ndërtimin e lidhjeve me anëtarë është pjesë e rëndësishme e çdo nisme dhe pune që synon të bëjë ndryshim progresiv shoqëror. Në mënyrë që qytetarët të bëhen faktorë aktivë të ndryshimit, nismat e shoqërisë civile duhet t'i përfshijnë praktikën më të mirë të përfshirjes, angazhimit dhe llogaridhënies që e tejkalon rolin e qytetarëve dhe të përfituesve të fundit pasivë të ndërhyrjeve.

Ndonëse nismat e mbështetura nga KCSF do të kenë qasje në mentorim dhe ndërtim të kapaciteteve për t'i zhvilluar kompetencat thelbësore në angazhimin e anëtarëve, aplikantët duhet ta demonstrojnë qasjen e tyre të ndërmarrë deri më tani dhe mënyrën si synojnë t'i arrijnë dhe pasqyrojnë nevojat e qytetarëve në punën e tyre.

Gjatë zhvillimit të një ndërhyrjeje dhe përcaktimit të grupit të synuar, aspektet e rëndësishme që duhet të merren parasysh gjatë kryerjes së analizës janë dinamikat e pushtetit brenda shoqërisë. Kush nuk është përfshirë dhe pse? Kush përfiton nga mënyra në të cilën po bëhen gjërat? Me rastin e hartimit të ndërhyrjes, përmes cilës lente përcaktohet problemi? (d.m.th. nëse ndërhyrja e propozuar synon t'i përmirësojë kushtet e komunitetit rom, a ka qenë ndonjë rom i përfshirë në hartim të saj, apo kanë qenë vetëm anëtarët e komunitetit shumicë shqiptar?)

Aplikantët duhet ta paraqesin një analizë të qartë të grupit të tyre të synuar, të tregojnë pse angazhimi dhe pjesëmarrja e tyre është e rëndësishme për punën e organizatës dhe mënyrat e ndryshme në të cilat synojnë t'i angazhojnë.

Ngjashëm, me rastin e analizimit të grupit të tyre të synuar, aplikantët pritet t'i dinë dallimet e grupeve të tyre të synuara (si gjinia, mosha, përkatësia etnike, feja, arsimi, vendndodhja, rrethanat socio-ekonomike, interesat dhe nevojat) dhe t'i përshtatin propozimet dhe ndërhyrjen e tyre sipas rrethanave.

Aplikantët gjithashtu pritet ta analizojnë potencialin e grupeve të synuara për angazhim dhe ta zhvillojnë një qasje realiste për rritje graduale, por sistematike, të përfshirjes së tyre në punën e organizatës.

Përcaktimi dhe angazhimi i grupeve të synuara - Cilat janë grupet e synuara të programit dhe a do të ketë ndonjë ndryshim në jetën e tyre në rast të mbështetjes nga KCSF? A e përfshin organizata juaj grupin e synuar në zhvillimin strategjik dhe në caktimin e përparësive? A ka organizata juaj burime të mjaftueshme në dispozicion për t'i angazhuar qytetarët? Në çfarë mënyre do të përfitojnë ata nga të qenët pjesë e procesit të konsultimeve? Si planifikoni t'i përfshini grupet e synuara në programet dhe aktivitetet e organizatës suaj?

Kush duhet të përfshihet dhe si do të përfshini qytetarët që synoni t'i arrini? Si keni ndërmend t'i përfshini qytetarët në punën e organizatës suaj? Cila është praktika juaj deri më tani në përfshirjen e qytetarëve në punën tuaj? Përshkruani çdo metodë të përdorur ose që planifikoni ta përdorni në përfshirjen e qytetarëve për t'i adresuar shqetësimet e tyre? Cilat janë mënyrat më të mira për t'i përfshirë qytetarët në ndërhyrjet tuaja?

Qasja ndaj programit/zhvillimit të projektit – Si do siguroheni që organizata juaj përfaqëson prioritetet e grupit të synuar? Cilat janë mënyrat e ndryshme në të cilat organizata juaj mund t'i angazhojë qytetarët në faza të ndryshme të zbatimit të programit? A bëni vlerësime të projekteve? A duhet përfituesit të marrin pjesë në dhënien e informatave kthyesë për zbatimin e programit, si dhe për postin e mëparshëm? A planifikoni ndonjë përparim të kësaj praktike në të ardhmen?